



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.52/2019  
Prishtinë, më 21.5.2019

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu, Fisnik Ismaili dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Saranda Bogujevci dhe Shemsi Sylja.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari, Avokat i Popullit, Mehdi Geci, Zëvendësavokat i Popullit, Ilir Meha, familjar e i familjes së Tahir Mehes, Zade Meha, Fazli Kastrati, Naim Zhitia, Naser Behrami dhe Rexhep Behrami, përfaqësues së Shoqatës së ish të Plagosurve në kohën e para fillimit të luftës, Naxhie Skenderi, shoqata e grave në luftë të kancerit të gjirit në Rrafsh të Dukagjinit, Yllka Alimusaj, KDI, Nexhmije Berisha, LDK, Nora Kelmendi-Ekonomia Online, Drita Vitia-Radio Kosova, Aurela Elshani, RTV21, Erduan Zeqiri, Kosova Press dhe Selman Krasniqi-qytetar.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë:

**Rend dite:**

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 2. Diskutim në komision lidhur me çështjen e statusit të personave të plagosur në Kosovë, para periudhës së luftës. Të ftuar: Skender Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfaqësues të Shoqatës dhe Hilmi Jashari, Avokat i Popullit;**
- 3. Diskutim në Komision lidhur me çështjen e petitionit të Kryesisë së Federatës së Sindikatave të Pavarura Elektro-Kosova (FSPE) për moszbatimin e vendimeve të Gjykatës për kthimin e punëtorëve në punë;**

#### **4. Të ndryshme.**

##### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

Kryetarja, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur me dt. 17 prill 2019, u miratua pa vërejtje.

##### **2. Diskutim në Komision lidhur me çështjen e statusit të personave të plagosur në Kosovë, para periudhës së luftës. Të ftuar: Skender Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfaqësues të Shoqatës dhe Hilmi Jashari, Avokat i Popullit**

Kryetarja tha se prezent në këtë mbledhje kemi përfaqësuesit e ish të plagosurve para luftës dhe Avokatin e Popullit.

Naim Zhitia tha se përfaqëson Shoqatën e themeluar vullnetarisht që nga viti 2009, pikërisht për kategoritë e personave të cilët kanë qenë të vrarë dhe të plagosur në demonstrata para vitit 1990.

Ai sqaroi se me mirëkuptimin e Institucioneve janë pranuar të vrarët, por, jo edhe të plagosurit nëpër demonstratat e viteve 1968, 1981, 1989, 1990, e kështu me radhë. Tha se për këtë kategori kërkojnë nga Institucionet e Kosovës që të u pranohet e drejta me ligj sikurse të plagosurve në luftë.

Hilmi Jashari tha se këtë kërkesë si Institucion nuk e kishin, por, pasi kishin ftesën nga Komisioni kanë bërë një vlerësim të shpejtë mbi bazën ligjore për të parë mundësit çfarë janë. Dhe në fakt e vetmja mundësi ligjore deri më tani është ligji që parasheh kategoritë e dala nga lufta por, për fat të keq kjo kategori e personave që po flasim tani nuk janë të përfshirë në përkufizimet e këtij ligji, përjashtimisht një dispozitë e cila u referohet personave që kanë humbur jetën.

Më tej, theksoi se njëri prej opsioneve eventuale për këtë kategori po qese ekziston një vullnet politik dhe një arsyetim objektiv për përfshirjen e kësaj kategorie është ndryshim plotësimi i këtij ligji, siç është bërë me plotësimin e njohje së statusit për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës.

Illir Meha, tha se kërkojnë nga Institucionet e shtetit që të u njihet kjo e drejtë legjitime, ashtu siç njihen të drejtat e invalidëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse edhe plagët e këtyre të plagosurve para luftës kanë vlerën e vet.

Kryetarja, tha se si Komision për të Drejtat e Njeriut, do të kontribuojmë për këtë çështje, por kjo varet se kur do të vije te ndryshimi i këtij ligji, qoftë nga Qeveria, apo qoftë edhe nga Komisioni Funkcional.

Komisioni që unë drejtoj do të ofrojë mbështetje të plotë për këtë kategori.

Teuta Haxhiu tha se ky problem i ngritur me vonesë është shqetësim, është një e drejtë e plotë dhe se kanë mbështetjen nga ana e saj, pa shkelur ligjin, por në pajtim me rregullat dhe procedurat.

Mirjeta Kalludra, tha se edhe pse vonë, përkrah përfshirjen e të drejtave të kësaj kategorie në ligj, për këtë beson se do të kenë përkrahjen e komisionit dhe përkrahjen e saj personale.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se i vjen keq që nuk është prezent ministri Skender Reçica, sepse është një çështje që i takon asaj ministrie, tha se mbështetja nga ana e komisionit nuk diskutohet dhe beson se një përkrahje për këtë kategori do të jetë unike.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se do të jetë zëri i juaj, do ta keni përkrahjen, e dinë se këto demonstrata kanë ndodhur në të gjitha qytetet e Kosovës për të kërkuar lirinë e vendit dhe pikërisht është kjo arsye që nuk ka nevojë me fol shumë sepse po kërkonin një gjë që u takon. Ajo tha se ka informata se është në ndryshim dhe plotësim ligji për familjet e dëshmorëve dhe këtu jemi të gjithë bashkë, qoftë edhe për të iniciua ndryshim plotësimin e këtij ligji, në qoftë se ministria nuk është duke punuar dhe do të shohim se si do të lëvizim këtë çështje për t'i dhënë zgjidhjen që ju e meritoni, e që padrejtësisht jeni anashkaluar.

Lirije Kajtazi tha se kjo çështje është ngritur në komision dhe se do të duhej parë mundësitë për përshpejtimin e këtij procesi, është mirë që është vendosur në tavolinë. Ajo tha se në parim nuk duhet dhënë ngjyrë partiake kësaj çështjeje dhe është e bindur se ky mos hezitim për të gjetur mundësi për ta zgjidhur këtë çështje, do të përshpejton edhe zgjidhjen dhe krejt respektin për këtë kategori.

Fisnik Ismaili theksoi se nuk ka qenë në dijeni për këtë padrejtësi që u është bërë kësaj kategorie, dhe se kjo kategori meriton një kërkim falje të madhe institucionale për krejt injorimin që është bërë ndaj jush deri tash. Tha se për zgjidhjen e kësaj çështjeje do ta keni mbështetjen e plotë të anëtarëve të komisionit por edhe deputetëve të tjerë.

Veton Berisha tha se gjithashtu keni përkrahjen e tij si deputetë, por edhe të Grupit parlamentar që ai i takon dhe në të njëjtën kohë është mirë me gjetur rrugën më të shkurtër të ndryshimit të këtij ligji, pasi shihet se të gjithë kemi vullnetin për të bërë një gjë të tillë, sepse kjo kategori do trajtim të veçantë.

Kryetarja, në fund, konstatoi se siç u pa nga diskutimet, ka një mbështetje të plotë që kjo kategori të përfshihet në ligj dhe beson se kjo do të arrihet me një rrugë sa më të shkurtër dhe të shpejtë, dhe këtë do ta arrimë së bashku.

### **3. Diskutim në komision lidhur me çështjen e petitionit të Kryesisë së Federatës së Sindikatave të Pavarura Elektro-Kosova (FSPE) për moszbatimin e vendimeve të Gjykatës për kthimin e punëtorëve në punë**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryetarja propozoi që të vizitohet menaxhmenti i KEDS-it, në mënyrë që të bisedojmë drejtpërdrejt lidhur me këtë çështje.

Kryetarja, konstatoi se komisioni vendosi të vizitoj menaxhmentin e KEDS, por nuk u caktua data e vizitës.

### **4. Të ndryshme**

Në këtë pikë të rendit të ditës kryetarja tha se kemi disa palë të cilat kanë ardhur dhe do ua japim fjalën shkurt për t'i sqaruar kërkesat e tyre.

Naxhie Skenderi, përfaqësuese e Shoqatës së Grave për Mbrojtje nga Kanceri i Gjirit në Rrafsh të Dukagjinit, tha se me kërkesat e kësaj shoqate janë të njoftuar të gjitha organet në nivel të Kosovës, por edhe në nivel të komunës. Meqë kërkesat nuk e realizuan, tha se kanë qenë të obliguar të bëjnë një peticion ku kanë mbledhur më shumë se 12 mijë nënshkrime.

Kërkesa e parë ka të bëjë me hapjen e një degë e onkologjisë në Komunën e Pejës, kërkesa tjetër është që hormono terapia të ofrohet në këtë komunë, kërkesa e tretë është që së paku një herë në javë në këtë komunë të ketë vizita të reumatologut dhe onkologut.

Më tej tha se sigurimet shëndetësore të bëhen sa më shpejt, të bëhet lirimi nga të gjitha pagesat dhe incizimeve të ndryshme që janë të nevojshme për zbulimet e hershme, sepse poenta duhet të jetë te parandalimi i këtyre sëmundjeve.

Naxhie Skenderi shprehu pakënaqësitë, siç tha ajo, që u bëhen pacienteve në klinikën në Prishtinë, tha se pacientët që janë nga rajoni i Prishtinës trajtohem më mirë se sa të rajoneve të tjera.

Kryetarja, konstatoi se komisioni ka një grup punues që i shqyrton peticionet dhe aty do të shtjellojnë në hollësi kërkesat e kësaj shoqate.

Selman Krasniqi tha se si qytetar i këtij vendi, ka bërë një kërkesë lidhur me rritjen e pagës për 10% më shumë për gjininë femërore. Këtë kërkesë, tha se, ia ka dërguar Presidentit, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, Avokatit të Popullit dhe disa deputetëve, por deri tani kjo kërkesë ka hasur në vesh të shurdhër se kinse po dëmtohet buxheti, por kjo arsye nuk qëndron.

Kryetarja falënderoj palën për prezencën, tha se këtë kërkesë e kanë diskutuar edhe njëherë, është një temë interesante dhe do mundohen me ndihmua, por brenda kornizës së lejuar ligjore.

Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit se nesër është përvjetori i shënimit të 20- vjetorit të masakrës në Burgun e Dubravës, ky shënim mbahet me iniciativën e komisionit dhe nën patronatin e Kryetarit të Kuvendit.

Për këtë pikë foli edhe Mexhide Mjaku-Topalli, e cila ishte caktuar nga komisioni udhëheqëse e Këshillit Organizativ, e cila njoftoi anëtarët e komisionit, në detaje lidhur me këtë organizim. Ajo sqaroi se nisja për në Dubravë bëhet nga Kuvendi në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje